

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

DIZENJIM MODE

(2 vjeçar)

(Arsim i dyfishtë)

Niveli V i KSHK¹, referuar nivelit V në KEK²
(Pas të mesmes)

Kodi: D1-1-V-25

Hartuar në kuadër të zbatimit të sistemit Arsim i dyfishtë, me mbështetjen e Projektit
“Aftësi për Punë”, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
(SDC) dhe zbatuar nga Swisscontact

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimit
2.Korniza Evropiane e Kualifikimit

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) (pas të mesmes).**
- II. Profili profesional i individëve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të individëve në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.
 2. Kompetencat profesionale të individëve në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.
 3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 2 vite mësimore.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode – Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.**
- VIII. Përshkruesit e moduleve profesionale teorike/ praktike.**
- IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të zbatuar në biznes.**
- X. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK (pas të mesmes).

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, është *“të përgatitë krijues të kualifikuar në fushën e modës të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me krijimin, prodhimin dhe konfeksionimin e produkteve të modës, si dhe të zhvillojë jo vetëm personalitetin krijues, por edhe personalitetin e tyre si qytetarë në përshtatje me mjedisin që i rrethon”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale në nivelin pas të mesëm, u krijon individëve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe krijuese, si dhe vlerat artistike dhe morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar nga pikëpamja artistike, psikologjike dhe fizike, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin, gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i individëve që ndjekin kualifikimin profesional “Dizenjim mode – Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të individëve në kualifikimin profesional, “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen ata individë që:

- Kanë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).
- Janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- Kanë aftësi ndryshe, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Nëse kërkesat për të ndjekur këtë kualifikim profesional janë më të larta se kapacitetet reale të shkollave, atëherë, institucioni përgjegjës përgatitë udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi.

2. Kompetencat profesionale të individit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit kualifikimit profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, individ do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të mbikëqyrë organizimin ergonomik dhe funksional të hapësirës së punës.

- Të mirëmbajë mjetet e punës dhe materialet, sipas standardeve të higjienës dhe sigurisë.
- Të përdorë teknika të thjeshta të manipulimit të tekstileve në përgatitjen e produkteve të modës.
- Të përdorë informacionin e etiketës dhe markës për të identifikuar përbërjen, mënyrën e mirëmbajtjes dhe përdorimit të materialeve gjatë procesit të punës.
- Të hartojë planin e koleksionit, veshjes ose produktit në përputhje me tendencat aktuale të modës.
- Të menaxhojë burimet njerëzore në funksion të kërkesave të projektit dhe objektivave të punës.
- Të përdorë informacione dhe të dhëna nga burime të ndryshme për të përcaktuar nevojat dhe preferencat në funksion të tregut si dhe për krijimin e koleksionit.
- Të zhvillojë ide dizajni modern, duke u bazuar në elemente të historisë, të trashëgimisë kulturore shqiptare, siluetat, skicat, proporcionet, ngjyrat, teksturat dhe njohuritë mbi periudhat stilistike dhe ciklet e modës.
- Të kryejë testime të ndryshme në varësi të llojit të tekstit.
- Të ndërtojë prototipin e produkteve të dizenuara me mënyra të ndryshme.
- Të mbikëqyrë realizimin e produkteve të modës, sipas dizajnit të koleksionit.
- Të menaxhojë dokumentet ligjore, teknike dhe financiare në një atelie ose studio mode.
- Të kryejë llogaritje të nevojshme për materialet, mjetet, shërbimet, si dhe çmimin përfundimtar të një produkti apo shërbimi.
- Të menaxhojë fushata promovimi për produkte apo shërbime mode.
- Të komunikojë saktë dhe në mënyrë profesionale me eprorët, bashkëpunëtorët, klientët, etj.
- Të bashkëpunojë në mënyrë efektive me kolegë dhe specialistë të tjerë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe standardet në fuqi për aspekte të ndryshme në fushën e modës.
- Të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në vendin e punës.
- Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave për ndarjen e mbetjeve dhe depozitimimin e tyre.
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet, si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, e pajis individin me certifikatën profesionale dhe suplementin përkatës të këtij kualifikimi. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të produkteve të modës, atelie mode apo dhe të vetëpunësohet në sipërmarrje private.

Me mbarimin e arsimimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode -Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, individi është i aftë të dalë në tregun e punës si dizenjues mode.

Me përfundimin e këtij niveli arsimimi, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm në arsimin e lartë universitar në fushën e modës dhe dizajnit.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK (2 vjeçar).

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, Niveli V i KSHK (2 vjeçar)				
Nr	Kodi	Modulet dhe praktika mësimore	Orët mësimore Viti I	Orët mësimore Viti II
A.		Modulet profesionale teorike/ praktike (Gjithsej)	360 orë mësimore	360 orë mësimore
1	M-10-2244-25	Mjetet e punës dhe materialet	43	-
2	M-38-2246-25	Komunikimi dhe sipërmarrja në dizenjim mode	33	-
3	M-05-2247-25	Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në dizenjim mode	30	-
4	M-10-1079-25	Teknologji tekstili	50	-
5	M-10-2245-25	Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave manuale artistike	50	-
6	M-10-1073-25	Modelimi industrial dhe konfeksionimi	154	68
7	M-10-2248-25	Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin	-	108
8	M-10-2249-25	Planifikimi dhe organizimi i punës në dizenjim mode	-	72
9	M-10-2250-25	Ideimi dhe skicimi i aksesoreve	-	45
10	M-10-2251-25	Modelimi i aksesoreve		32
11	M-10-2252-25	Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave grafike digjitale	-	35
12	P-10-016-25	Praktikë profesionale e grupuar, në biznes	900	900
Gjithsej			1260 orë mësimore	1260 orë mësimore

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor për kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK (pas të mesmes), zgjat 2 vite mësimore me kohëzgjatje të përgjithshme prej 2520 orësh mësimore, me këtë ndarje:

Një javë mësimore ka 5 ditë mësimore. Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kohëzgjatja e vitit të I-rë është 30 javë.

Kohëzgjatja e vitit të II-të është 32 javë (30 javë mësimore + 2 javë provime përfundimtare).

Një ditë praktike profesionale në biznes = 6 orë pune = 8 orë mësimore (16 – 18 vjeç).

Një ditë praktike profesionale në biznes = 8 orë pune = 10 orë mësimore (> 18 vjeç).

Viti I: 30 javë – 1260 orë mësimore

Modulet profesionale teorike/praktike realizohen në shkollë:

30 javë mësimore x 2 ditë mësimore/javë x 6 orë mësimore/ditë = 360 orë mësimore.

Praktika profesionale realizohet në biznes:

30 javë mësimore x 3 ditë mësimore/javë x 10 orë mësimore/ditë = 900 orë mësimore.

Viti II: 32 javë – 1260 orë mësimore

Modulet profesionale teorike/praktike realizohen në shkollë:

30 javë mësimore x 2 ditë mësimore/javë x 6 orë mësimore/ditë = 360 orë mësimore.

Praktika profesionale realizohet në biznes:

30 javë mësimore x 3 ditë mësimore/javë x 10 orë mësimore/ditë = 900 orë mësimore.

Provimet përfundimtare teorike dhe praktike: 2 javë

Skeletkurrikuli i arsimit profesional kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, përbëhet nga modulet profesionale teorike, teoriko-praktike dhe praktike (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli), si dhe nga formati i rekomanduar i programit të praktikës profesionale të grupuar, në biznes (tregohet në faqen e fundit të këtij dokumenti).

V. Udhëzime për procesin mësimor.

A. Udhëzime për realizimin e procesit mësimor teoriko-praktik në shkollë.

Rekomandohet që modulet profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe. Renditja e realizimit të moduleve profesionale bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika etj.), si dhe kushtet konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e individëve.

Mësimdhënësit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të individëve dhe të çojnë në krijimin e atyre, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së individëve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të teorisë me praktikën në to, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla dhe rajoni për realizimin e veprimtarive mësimore teorike dhe praktike etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës, si dhe lidhje e ngushtë me bizneset në fushën e modës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i individëve*. Njohja e vazhdueshme e individëve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësimdhënësit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të nxënësit në shkollat profesionale që ofrojnë kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

Mësimdhënësit duhet të përdorin metoda të tilla të të nxënësit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të individëve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj

jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi, si dhe profesionit, në veçanti. *Puna në grup* dhe *Detyrat praktike* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësimdhënësit është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e individëve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, Niveli V i KSHK. Në rastin e individëve me aftësi të kufizuara, mësimdhënësit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

B. Udhëzime për realizimin e praktikës profesionale në biznes.

Realizimin e praktikës profesionale në biznes duhet të krijojë mundësi për një zbatim të kompetencave në realitetin profesional të modës. Biznesi duhet të caktojë personin përgjegjës (instruktorin e biznesit) për mbështetjen e individëve në realizimin e programit të praktikës, në bashkëpunim me mësimdhënësin e shkollës, si dhe gjatë kohës kur ky i fundit nuk është prezent gjatë kësaj praktike. Shkolla duhet të informojë biznesin për numrin e individëve që do të kryejnë praktikën në këtë biznes, periudhën kohore, programin e praktikës dhe programin mësimor që kanë kryer më parë në shkollë. Rekomandohet që Praktika profesionale në biznes të kryhet në blloqe javore, duke konsideruar edhe mundësitë e bizneseve.

Planifikimi i realizimit të praktikës në biznes duhet të bazohet në një proces analize fillestare duke marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, programi i përgjithshëm i praktikës në biznes, niveli i hyrjes së individëve, përmbajtja mësimore e realizuar më parë në shkollë, objektivat konkretë që do të arrihen në biznes, mundësitë dhe kushtet e biznesit për realizimin e praktikës së individëve etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i koordinatorit të marrëdhënieve me biznesin, personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës, si dhe i përfaqësuesve të biznesit.

Shkolla është e detyruar që, nëpërmjet mësimdhënësit të shkollës, përgjegjës për praktikën profesionale në biznes, të mbikëqyrë dhe mbështesë realizimin e programit, bazuar në kontratat dhe marrëveshjet paraprake.

Programi i detajuar i realizimit të praktikës profesionale në biznes, raportet e ecures së praktikës, shkalla e përmbushjes së programit, si dhe fletët e vlerësimit të individëve duhet të jenë pjesë e dokumentacionit për realizimin e kësaj praktike në biznes.

Instruktori i biznesit, në bashkëpunim me mësimdhënësin e shkollës, duhet të përfshijë, motivojë, mbikëqyrë dhe vlerësojë individët në të gjitha veprimtaritë e parashikuara në program. Dhënia e përgjegjësisë në vendin e punës, puna e mbikëqyrur dhe e pavarur duhet të jenë pjesë e realizimit të programit.

Individi duhet të dokumentojë në portofolin e tij të gjitha përvojat dhe rezultatet nga praktika profesionale në biznes, të përgatitë një raport dhe t'a prezantojë në klasë, si pjesë e këtij portofoli.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i individëve për modulet profesionale bëhet nga mësimdhënësit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i individëve të bëhet me nota ($4 \div 10$) për modulet profesionale, për praktikën profesionale të

grupuar dhe për provimet përfundimtare.

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK, pas të mesëm, individët i nënshtrohen provimeve përfundimtare të mëposhtme (bazuar në programin orientues përkatës):

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar.
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të kualifikimit profesional “Dizenjim mode – Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

VII. të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode – Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK.

Me përfundimin e sukseshëm të këtij kualifikimi profesional, individët marrin Certifikatën profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës për këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për individin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet (notat) e arritura nga individ:

 - rezultatet në modulet profesionale;
 - rezultatin e praktikës profesionale në biznes;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit V të KSHK.

VIII. Përshkruesit e moduleve profesionale teorike /praktike

1. Moduli “Mjetet e punës dhe materialet”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MJETET E PUNËS DHE MATERIALET	M-10-2244-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përshkruar mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës, për të përdorur teknika manuale dhe digjitale për dizenjim, si dhe mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës.	
Kohëzgjatja e modulit	43 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individi përshkruan mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të listojë mjetet dhe materialet e punës për realizimin e kallëpit të produkteve të modës; – të klasifikojë materialet tekstile, lëkura, gëzofë të përdorura për realizimin e produkteve të modës; – të përshkruajë karakteristikat themelore të materialeve tekstile, lëkurave, gëzofëve; – të listojë mjetet manuale të punës të nevojshme për prerjen e pjesëve të produktit të modës; – të përshkruajë makineritë për prerjen e pjesëve të produktit të modës; – të listojë mjetet e punës për realizimin e veshjeve në manekinë; – të listojë mjetet dhe materialet e punës të nevojshme për qepjen e produktit të modës; – të përshkruajë makineritë për hekurosjen e produktit të modës; – të shpjegojë rëndësinë dhe përmbajtjen e etiketës; – të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës. Instrumentet e vlerësimit:	

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 2 Individi përdor teknika manuale dhe digjitale për dizenjimin e produktit të modës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të listojë teknikat për realizimin e dizajnit artistik të produktit të modës;
- të përdorë mjetet e punës për realizimin e dizajnit me anë të teknikave grafike manuale;
- të përdorë mjetet e punës për realizimin e dizajnit me anë të teknikave grafike manuale;
- të përdorë pajisjet dhe programet digjitale për realizimin e dizajnit me anë të teknikave digjitale;
- të përdorë pajisjet dhe programet digjitale të përdorura për realizimin e dizajnit me anë të teknikave digjitale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi përdor mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë mjetet dhe materialet e punës për realizimin e kallëpit të produkteve të modës;
- të përdorë mjetet manuale të punës të nevojshme për prerjen e pjesëve të produktit të modës;
- të përdorë makineritë e përdorura për prerjen e pjesëve të produktit të modës;
- të përdorë mjetet e punës të përdorura për realizimin e veshjeve në manekinë;
- të përdorë mjetet dhe materialet e punës të nevojshme për qepjen e produktit të modës;
- të përdorë makineritë e nevojshme për qepjen e produktit të modës;
- të përdorë makineritë e nevojshme për hekurosjen e produktit të modës;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të realizohet në laboratorin praktik për dizenjues mode dhe biznes.

dhe për vlerësimin e individëve	– Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës, për të përdorur teknika manuale dhe digjitale për dizenjim, si dhe mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës. – Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës, për të përdorur teknika manuale dhe digjitale për dizenjim, si dhe mjetet dhe materialet për realizimin e produktit të modës. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Metër për marrjen e përmasave trupore. – Mjete për ndërtimin e kartmodelit (kurbalinja, laps, vizore, letër kalk, makinë llogaritëse, programe digjitale). – Mjete dhe materiale pune për realizimin e qepjes së produktit të modës (makina qepëse, makina prerëse, makina hekurosëse, gjilpëra, gërshërë, sapun shënues, kopsa, zinxhir, frazelinë, tekstil, astar). – Mjete pune për skicim (ngjyra, laps, tablet/kompjuter, programe digjitale për skicim).

2. Moduli “Komunikimi dhe sipërmarrja në dizënjim mode”

Kualifikimi profesional: “Dizënjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI DHE SIPËRMARRJA NË DIZENJIM MODE	M-38-2246-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të komunikuar me etikë profesionale në sektorin e modës, për të respektuar normat etike në punën në grup, për të përshkruar kuadrin ligjor dhe dokumentacionin në sipërmarrje mode, si dhe për të hartuar një plan biznesi në dizënjim mode.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individi komunikon me etikë profesionale në sektorin e modës. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë rëndësinë e komunikimit etik dhe profesional; – të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët, bashkëpunëtorët dhe klientët; – të komunikojë në mënyrë profesionale me eprorët, klientët, bashkëpunëtorët, etj.; – të përdorë në mënyrë të saktë terminologjinë profesionale; – të analizojë rëndësinë e respektimit të kodit të etikës; – të zbatojë kodin e etikës dhe të ruajë privatësinë e informacionit; – të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet me eprorët/stafin dhe klientët; – të zbatojë teknologjitë e reja të komunikimit; – të respektojë barazinë gjinore, kulturore dhe etnike, gjatë komunikimit profesional. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. – Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Individi respekton normat etike në punën në grup. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë parimet bazë të punës në grup;	

- të analizojë rëndësinë e ndërveprimit profesional me kolegët dhe eprorët;
- të shpjegojë rolin e bashkëpunëtorëve në realizimin e detyrave;
- të komunikojë qartë për ndarjen e detyrave dhe koordinimin e punës në grup;
- të marrë dhe japë vendime në mënyrë të argumentuar dhe të kuptueshme;
- të përdorë terminologjinë profesionale, gjatë diskutimeve dhe zgjidhjes së problemeve;
- të menaxhojë në mënyrë të drejtë mendimin kritik, gjatë përballjes me sfida profesionale;
- të identifikojë dhe zgjidhë konflikte me kolegët apo klientët në mënyrë të qetë dhe etike;
- të përdorë metoda të ndryshme informacioni për zgjidhjen e problemeve të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi përshkruan kuadrin ligjor dhe dokumentacionin në sipërmarrje mode.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet administrative bazë në një studio mode;
- të shpjegojë dispozitat themelore të Kodit të Punës;
- të menaxhojë lloje të ndryshme dokumentesh (kontrata, fatura, skeda teknike, oferta);
- të përdorë mjete digjitale për përpunim, ruajtje dhe arkivim të të dhënave;
- të mbikëqyrë dokumentacionin shoqërues dhe procesin e inventarizimit në njësi sipërmarrëse mode;
- të shpjegojë rolin e kuadrit ligjor mbi të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale;
- të dallojë pronësinë intelektuale nga ajo industriale;
- të përshkruajë funksionin e institucioneve përkatëse (ZSHDA, DPPM, DPD, DPPSH);
- të analizojë raste praktike të shkeljes së të drejtave të dizajnit në modë, si dhe trajtimin e tyre në aspektin ligjor;
- të ruajë standardet e etikës dhe privatësisë, gjatë menaxhimit të dokumentacionit profesional.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 4 Individi harton një plan biznesi në dizajn mode.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet administrative dhe menaxheriale në një atelie apo studio mode;
- të shpjegojë mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacionit ligjor, teknik dhe financiar;
- të shpjegojë konceptet bazë të menaxhimit të projektit, përfshirë llogaritjen e kostove dhe përgatitjen e grafikut të punës;
- të përgatitë një ofertë të thjeshtë për produkte apo shërbime në dizënjim mode;
- të përshkruajë rëndësinë e motivimit të stafit dhe mënyrat për vlerësimin e tij në njësi sipërmarrëse të modës;
- të analizojë vetveten në funksion të zhvillimit profesional, përmes identifikimit të aftësive dhe interesave;
- të ndjekë aktivitete profesionale dhe trajnuese për përmirësimin e aftësive si trajnime, kurse teknike, panairë dhe ekspozita, shfaqje mode;
- të rendisë dhe përshkruajë format kryesore të sfilatave, ekspozitave, konkurseve kreative dhe rolin e tyre promovues për dizajnerët e rinj;
- të hartojë një plan biznesi në përputhje me prirjet e tij profesionale në dizënjim mode;
- të përgatitë një prezantim të shkurtër (*pitch*) me elemente bazë të planit të biznesit (emër, logo, mision, klientë, forma prezantimi);
- të identifikojë burimet e nevojshme për realizimin e produktit (materiale, pajisje, kohë);
- të përdorë mjete digjitale për krijimin e prezantimit dhe elementëve grafikë bazë;
- të prezantojë idenë e planit të biznesit në mënyrë kreative;
- të vlerësojë mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të idesë së tij si sipërmarrës në sektorin e modës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizënjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të komunikuar me etikë profesionale në sektorin e modës, për të respektuar normat etike në punën në grup, për të përshkruar kuadrin ligjor dhe dokumentacionin në sipërmarrje mode, si dhe për të hartuar një plan biznesi në dizënjim mode.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të komunikuar

	me etikë profesionale në sektorin e modës, për të respektuar normat etike në punën në grup, për të përshkruar kuadrin ligjor dhe dokumentacionin në sipërmarrje mode, si dhe për të hartuar një plan biznesi në dizajn mode. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Pajisje teknologjike (kompjuter, projektor, akses në internet) për realizimin e prezantimeve digjitale, punën me dokumente dhe simulime ligjore. – Formularë, skeda teknike, mjete për punë në grup, postera ose mjete për punë vizuale, akses në platforma ose programe bazë për dizajn grafik (si Canva ose PowerPoint). – Kodi i Punës (ligji për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale). – Udhëzues për ndërtimin e një ideje biznesi. – Manuale, udhëzues, demonstrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në dizenjim mode”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK DHE TË MBROJTJES SË MJEDISIT NË DIZENJIM MODE	M-05-2247-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përshkruar rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në mjedisin e punës, për të zbatuar normat e cilësisë dhe të sigurisë, si dhe rregullat e kushteve klimatike, gjatë veprimtarive në mjedisin e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individ i përshkruan rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në mjedisin e punës. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë rreziqet dhe shkaqet e tyre, gjatë punës në laborator; – të përshkruajë rregullat dhe standardet e sigurisë në laborator; – të përshkruajë mjediset e laboratorit dhe rreziqet përkatëse; – të përshkruajë rreziqet mekanike, fizike, kimike, biologjike, ergonomike dhe psikologjike, si dhe ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre; – të planifikojë veprimet në raste rreziku; – të përdorë pajisjet dhe mjetet për mbrojtje individuale. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. – Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Individ i zbaton normat e cilësisë dhe të sigurisë, gjatë veprimeve në ambientin e punës. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë rëndësinë dhe përparësitë e normave dhe standardeve të cilësisë në mjedisin e punës; – të zbatojë procedura të sigurt, gjatë proceseve të	

- ndryshme;
- të zbatojë rregullat për shmangien e qëndrimeve jo komode;
- të përshkruajë rëndësinë e dokumentacionit që përdoret në sistemet e cilësisë së ambientit;
- të demonstrojë procedurat laboratorike, në përputhje me normat standarde;
- të zbatojë parametrat e cilësisë, saktësisë dhe sigurisë në ambientet e punës;
- të ilustrojë rregullat dhe masat që duhen marrë në një mjedis pune.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi zbaton rregullat e kushteve klimatike, gjatë veprimtarive në mjedisin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e kushteve optimale (ndricim, dimensionet e dhomës, hapësirën e nevojshme, si dhe ventilimin për mbarëvajtjen e proceseve të punës, gjatë veprimtarisë në mjedisin e punës;
- të përshkruajë pasojat nga mos-zbatimi i rregullave dhe kushteve optimale, gjatë veprimtarisë në laborator;
- të zbatojë rregullat kryesore për mirëmbajtjen e mjedisit, gjatë veprimtarisë së tij;
- të zbatojë rregullat kryesore për mbrojtjen e mjedisit, gjatë veprimtarisë në laborator.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizajnues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar rregullat e sigurisë për shmangien e rrezeve në mjedisin e punës, për të zbatuar normat e cilësisë dhe të sigurisë, si dhe rregullat e kushteve klimatike, gjatë veprimtarive në mjedisin e punës.
- Individet duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar rregullat e sigurisë për shmangien e rrezeve në mjedisin e punës, për të zbatuar normat e cilësisë dhe të sigurisë, si dhe

	rregullat e kushteve klimatike, gjatë veprimtarive në mjedisin e punës. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore. – Laborator fiziko- mekanik dhe kimik i tekstilit. – Laborator i projektimi dhe prodhimit të veshjeve. – Tabela dhe pankarta ilustruese. – Pajisje dhe mjete laboratorike. – Reagentë kimikë dhe materiale të tjera laboratorike. – Dokumente të normave dhe standardeve për veprimet laboratorike. – Rregullore të cilësisë dhe sigurisë në laboratorët fiziko – mekanik dhe kimik. – Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Teknologji tekstili”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TEKNOLOGJI TEKSTILI	M-10-1079-25
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i aftëson individët për të përshkruar dhe identifikuar veçoritë e fibrave tekstile, proceset e prodhimit të fijeve dhe tekstileve, si dhe proceset e përpunimit dhe trajtimit të tekstileve, gëzofëve, lëkurave.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individ i përshkruan veçoritë dhe identifikon fibrat tekstile. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të klasifikojë fibrat tekstile; – të shpjegojë karakteristikat e fibrave bimore; – të shpjegojë karakteristikat e fibrave shtazore; – të shpjegojë karakteristikat e fibrave të krijuara nga njeriu; – të shpjegojë karakteristikat e lëkurave natyrore; – të identifikojë secilën nga fibrat tekstile në mënyrë organoleptike. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. RN 2 Individ i përshkruan proceset e prodhimit të fijeve dhe tekstileve. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të klasifikojë sistemet e filaturimit të fibrave; – të përshkruajë sistemet e filaturimit të fibrave; – të shpjegojë treguesit kryesorë të fijeve; – të llogarisë hollësinë e fijeve; – të shpjegojë numrat e fijeve; – të përshkruajë mënyra të ndryshme të prodhimit të tekstileve; – të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve të tezgjahuara; – të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve të	

- trikotuara;
- të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve pa thurje;
- të shpjegojë krakteristikat e tekstileve të trikotuara dhe tezgjahuara;
- të përzgjedhë tekstilet në përshtatje me cilësinë dhe kërkesat teknike të nevojshme për realizimin e produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 3 Individi përshkruan proceset e përpunimit dhe trajtimit të tekstileve, gëzofëve, lëkurave.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë trajtimet e ndryshme që i kryhen tekstileve;
- të përshkruajë trajtimet e ndryshme që i kryhen lëkurave, gëzofëve;
- të përshkruajë procesin e mercerizimit;
- të përshkruajë procesin e fisnikërimit të tekstileve;
- të përshkruajë proceset e ngjyrosjes, zbardhimit;
- të përshkruajë llojet dhe teknikat e stampimit;
- të shpjegojë realizimin e tekstileve 3D;
- përzgjedhë tekstilet në përshtatje me cilësinë dhe kërkesat teknike të nevojshme për realizimin e produktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar dhe identifikuar veçoritë e fibrave tekstile, proceset e prodhimit të fijeve dhe tekstileve, si dhe proceset e përpunimit dhe trajtimit të tekstileve, gëzofëve, lëkurave.
- Individent duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar dhe identifikuar veçoritë e fibrave tekstile, proceset e prodhimit të fijeve dhe tekstileve, si dhe proceset e përpunimit dhe trajtimit të tekstileve, gëzofëve, lëkurave.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

**për realizimin e
modulit**

- Laboratori fiziko – mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës në profilin dizenjim mode.
 - Fibra, mostra materialesh tekstili, mikroskop, kompjuter, aparaturat vlerësimin e parametrave të tekstilit, mjete ndihmëse, reagentë kimik etj.
 - Manuale, udhëzues, demonstrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave manuale artistike”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REALIZIMI I FIGURINËS NË MODË NËPËRMJET TEKNIKAVE MANUALE ARTISTIKE	M-10-2245-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të zbatuar rregullat e proporcioneve në vizatimin e figurinës së modës, për të përdorur mjetet dhe teknikat e dizajnit artistik të figurinës, për të shprehur krijimet e veta, si dhe për të realizuar vizatimin teknik të veshjeve si pjesë e procesit të punës në industrinë e veshjes.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individ i zbaton rregullat e proporcioneve në vizatimin e figurinës së modës (kanonet). Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë rëndësinë e proporcionit në modë; – të shpjegojë kanonet historike të proporcioneve të trupit të njeriut; – të shpjegojë kanonin e modës dhe të paraqesë figurinën në tre pika shikimi; – të shpjegojë anatominë e trupit të njeriut; – të vizatojë në mënyrë proporcionale trupin e njeriut; – të shpjegojë ndarjen e raporteve proporcionale në skicim; – të vizatojë manekinin në poza statike dhe dinamike; – të vizatojë elementët e portretit sytë, hundën, gojën, veshët – të vizatojë portretin me proporcione të sakta; – të vizatojë portretin me modele të ndryshme të krehjes dhe me kapele; – të vizatojë në mënyrë proporcionale veshjen mbi figurinën e modës. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. – Vlerësim me listë kontrolli.	
	RN 2 Individ i përdor mjetet dhe teknikat e dizajnit artistik të	

figurinës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë mjetet dhe teknikat e vizatimit;
- të përdorë mjetet e thjeshta të vizatimit si: laps, portaminë, karbon, letër, karton, letra me ngjyra dhe fraktura e dizajne etj;
- të vizatojë portretin me volum, nëpërmjet teknikës së lapsit me dritë-hije;
- të vizatojë pjesët e tjera të figurinës si dorën, krahun, këmbën, bustin nëpërmjet dritë hijes ose linjës;
- të vizatojë me dritë hije ose linjës drejtimin që marrin palat e veshjeve në trupin e figurinës;
- të përcaktojë teknikën e vizatimit në varësi të karakteristikave të stilit dhe strategjisë së zhvillimit të modelit;
- të përdorë teknikat grafike të bardhë e zi në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të vizatojë koleksionin vizual në mënyrë të strukturuar për paraqitjen e tij.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi përdor figurinën e modës për të shprehur krijimet e veta, duke përdorur ngjyrën.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë mjetet dhe teknikat e skicimit;
- të vizatojë figurinën e modës;
- të stilizojë figurinën e modës;
- të dallojë figurinën teknike nga figurina për ilustrim;
- të përdorë teknikat e ngjyrave të tilla si: akuarelet, lapsat, lapustilat, pastelat, markerat, në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknikën e kolazhit në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknikat e përziera në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknika të ndryshme në dizenjimin e tekstileve;
- të përzgjedhë teknikën e vizatimit në varësi të karakteristikave të stilit dhe strategjisë së zhvillimit të modelit;
- të realizojë ilustrimin e ideve, sipas tematikës së përzgjedhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi realizon vizatimin teknik të veshjeve, si pjesë e procesit të punës në industrinë e veshjes.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë volumet dhe linjat bazë në veshje;
- të shpjegojë teknikat e ndërtimit të elementëve në vizatim;
- të vizatojë teknikisht elementët estetikë të veshjes (rifiniturat, palat, xhepat, etj);
- të vizatojë saktësisht elementët zbukurues të veshjes me detaje;
- të realizojë skicën e lirshmërisë së veshjes në vizatim;
- të realizojë skicën e veshjeve bazë;
- të realizojë skicën e mëngëve bazë;
- të realizojë skicën e manshetave (triko, bluza e këmisha);
- të realizojë skicën e llojeve të ndryshme të jakave dhe dekolteve;
- të realizojë skicën e modeleve të ndryshme të fundit;
- të realizojë skicën e modeleve të ndryshme të pantallonave;
- të realizojë skicën modeleve të ndryshme të xhaketave dhe jelekëve;
- të realizojë skicën e modeleve të ndryshme të xhaketave sportive dhe xhupave;
- të realizojë skicën e modeleve të ndryshme të jakave dhe detajeve sportive;
- të realizojë skicën e palltove, pardesyve, pelerinave;
- të realizojë skicën e veshjeve sportive;
- të realizojë skicën e aksesorëve si: çanta, kuleta, doreza, rripa, kapele, bizhu etj;
- të realizojë skicën të këpucëve, çizmeve, sandaleve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të zbatuar rregullat e proporcioneve në vizatimin e figurinës së modës, për të përdorur mjetet dhe teknikat e dizajnit artistik të figurinës, për të shprehur krijimet e veta, si dhe për të realizuar vizatimin teknik të veshjeve si pjesë e procesit të punës në industrinë e veshjes.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit

	të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të zbatuar rregullat e proporcioneve në vizatimin e figurinës së modës, për të përdorur mjetet dhe teknikat e dizajnit artistik të figurinës, për të shprehur krijimet e veta, si dhe për të realizuar vizatimin teknik të veshjeve si pjesë e procesit të punës në industrinë e veshjes. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Laboratori praktik për dizajnim mode. – Tavolinë, dosje, leter, karton, laps, portaminë, karbon, ngjyra akuarel, lapsa druri, lapustila, pastela, markerat etj. – Manuale, udhëzues, demonstrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Modelimi industrial dhe konfeksionimi”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT			
Titulli dhe kodi	MODELIMI KONFESKSIONIMI	INDUSTRIAL DHE	M-10-1073-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përshkruar mjetet e punës për anatominë e trupit të njeriut, për të konfeksionuar funde, pantallona, bluza dhe këmisha për femra dhe meshkuj.		
Kohëzgjatja e modulit	154 orë mësimore		
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).		
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individ i përshkruan mjetet e punës për anatominë e trupit të njeriut. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë mjetet e punës për matjen e trupit të njeriut; – të përshkruajë ndërtimin anatomik të trupit të njeriut; – të marrë saktë masat trupore; – të përdorë tabelën e pëmasave trupore; – të zbatojë rregullisht përdorimin e simbologjisë dhe të shenjimit. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. – Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Individ konfeksionon funde. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës; – të komunikojë me etikë profesionale; – të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit; – të marrë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e fundit të thjeshtë; – të ndërtojë kartmodelin e fundit të thjeshtë; – të ndërtojë kartmodelin e fundeve verë; – të ndërtojë kartmodelin e fundit me supanjë; – të përzgjedhë tekstilin në përshtatje me modelin e fundit;		

- të palosë tekstilin në varësi të modelit të fundit;
- të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit, duke ekonomizuar tekstilin;
- të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil, duke respektuar tolerancat për qepje, cikatjet;
- të presë saktë sipas shënimit të tekstilin dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë);
- të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrin e shenimeve nga ana tjetër e tekstilit;
- të bashkojë pjesët e fundit me ildi;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundit;
- të evidentojë defektet në trup, gjatë provës;
- të rregullojë defektet trupore të evidentuara në trup, gjatë provës;
- të kryejë syzatorin;
- të qepë pencat;
- të përgatitë qemerin;
- të kryejë qepjen e xhepave të ndryshëm;
- të qepë zinxhirin normal dhe të fshehtë në fund;
- të qepë astarin në fund;
- të montojë qemerin në fund;
- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve).
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e fundit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi konfeksionon pantallona për femra dhe meshkuj.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të marrë përmasat trupore të nevojshme për ndërtimin e kartmodelit e pantallonave për femra dhe meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e pantallonave klasike për femra dhe meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e fund- pantallonave për femra;
- të përzgjedhë tekstilin në përshtatje me modelin e pantallonit;
- të palosë tekstilin në varësi të modelit të pantallonit;
- të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit, duke ekonomizuar tekstilin;
- të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil duke

- respektuar tolerancat për qepje, cikatjet;
- të presë saktë sipas shënimit tekstilin dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë);
- të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrin e shenimeve nga ana tjetër e tekstilit;
- të bashkojë pjesët e pantallonit me ildi;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të pantallonit;
- të evidentojë defektet në trup, gjatë provës;
- të rregullojë defektet trupore të evidentuara në trup, gjatë provës;
- të kryejë syzatorin;
- të përgatitë qemerin;
- të kryejë qepjen e xhepave të ndryshëm;
- të qepë zinxhirin normal dhe të fshehtë;
- të kryejë qepjen e sallkisë;
- të montojë qemerin në pantallon;
- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve);
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e pantallonave për femra dhe meshkuj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi konfeksionon bluza dhe këmisha për femra dhe meshkuj.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të marrë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e bustit për femra;
- të marrë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e bustit për meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e bustit për femra;
- të ndërtojë kartmodelin e bustit për meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e modeleve të bluzës me spostim pencash;
- të ndërtojë kartmodelin e bluzës me mëngë reglan;
- të ndërtojë kartmodelin e bluzës me mëngë kimono;
- të ndërtojë kartmodelin e modeleve të ndryshme të jakave të sheshta dhe të ngritura;
- të ndërtojë kartmodelin e këmishës klasike për femra;
- të ndërtojë kartmodelin e këmishës klasike për meshkuj;
- të përzgjedhë tekstilin në përshtatje me modelin e bluzës/këmishës;
- të palosë tekstilin në varësi të modelit;

- të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit duke ekonomizuar tekstilin;
- të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil duke respektuar tolerancat për qepje, cikatjet;
- të presë saktë sipas shënimit tekstilin dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë);
- të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrin e shenimeve nga ana tjetër e tekstilit;
- të bashkojë pjesët e bluzës/këmishës me ildi;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të bluzës/këmishës;
- të kryejë evidentimin e defekteve në trup gjatë provës;
- të kryejë rregullimin e defekteve trupore të evidentuara në trup, gjatë provës;
- të kryejë syzatorin;
- të përgatitë jakën;
- të qepë jakën;
- të qepë penca të llojeve të ndryshme;
- të qepë mëngët;
- të qepë fileton, pastrimin e jakës, mostrat;
- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve);
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e bluzave dhe këmishave për femra dhe meshkuj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar mjetet e punës për anatominë e trupit të njeriut, për të konfeksionuar funde, pantallona, bluza dhe këmisha për femra dhe meshkuj.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar mjetet e punës për anatominë e trupit të njeriut, për të konfeksionuar funde, pantallona, bluza dhe këmisha për femra dhe meshkuj.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

**për realizimin e
modulit**

- Laboratori praktik për dizenjim mode.
 - Makina qepëse të drejta industriale, makinë overlock, veglat e dorës. tavolinë përprerje, tavolina për modelim, tavolinëhekuri dhe hekur me avull për hekurosje, pëlhura të ndryshme, letra për kartmodele, astare, elastikë, zinxhira, kopsa etj.
 - Manuale, udhëzues, demostrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Modelimi industrial dhe konfeksionimi”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT			
Titulli dhe kodi	MODELIMI KONFESKSIONIMI	INDUSTRIAL DHE	M-10-1073-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të konfeksionuar fustane, xhaketa, pallto për femra dhe meshkuj, për të realizuar veshje në manekinë, si dhe për të realizuar kartmodelin e veshjeve me metoda digjitale.		
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore		
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).		
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Individi konfeksionon fustane. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës; – të komunikojë me etikë profesionale; – të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit; – të marrë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e fustanit; – të vizatojë kartmodelin e fustanit të thjeshtë; – të vizatojë kartmodelin e fustanit të modeluar; – të përzgjedhë tekstilin në përshtatje me modelin e fustanit; – të palosë tekstilin në varësi të modelit; – të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit duke ekonomizuar tekstilin; – të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil, duke respektuar tolerancat për qepje, ciklatjet; – të presë saktë sipas shënimit tekstilin dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë); – të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrjen e shënimeve nga ana tjetër e tekstilit; – të bashkojë pjesët e fustanit me ild; – të kryejë provën e qëndrimit në trup të fustanit; – të kryejë evidentimin e defekteve në trup gjatë provës; – të kryejë rregullimin e defekteve trupore të evidentuara në trup gjatë provës;	

- të kryejë syzatorin;
- të përgatitë jakën;
- të qepë jakën;
- të qepë mëngët;
- të qepë pencat;
- të qepë fileton, pastrimin e jakës, mostrat;
- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve);
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e fustaneve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 2 Individi konfeksionon xhaketa për femra dhe meshkuj.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të marrë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e xhaketës për femra dhe meshkuj;
- të vizatojë kartmodelin e xhaketës klasike për femra;
- të vizatojë kartmodelin e xhaketës klasike për meshkuj;
- të përzgjedhë tekstin në përshtatje me modelin;
- të palosë tekstin në varësi të modelit;
- të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit duke ekonomizuar tekstin;
- të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil, duke respektuar tolerancat për qepje, cikatjet;
- të presë saktë sipas shënimit tekstin dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë);
- të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrjen e shënimeve nga ana tjetër e tekstit;
- të bashkojë pjesët e xhaketës me ildi;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të xhaketës;
- të kryejë evidentimin e defekteve në trup gjatë provës;
- të kryejë rregullimin e defekteve trupore të evidentuara në trup gjatë provës;
- të qepë pjesët e tekstit;
- të qepë xhepat;
- të qepë pjesët e astarit;
- të qepë mostrat;
- të bashkojë astarin me tekstin;
- të qepë jakën në trupin e xhaketës;
- të qepë mëngët;
- të qepë pencat;

- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve);
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e xhakëve për femra dhe meshkuj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi konfeksionon pallto për femra dhe meshkuj.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të përdorë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të marrë përmasat trupore të nevojshme për ndërtimin e palltos për femra dhe meshkuj;
- të ndërtojë kartmodelin e palltos klasike për femra;
- të ndërtojë kartmodelin e palltos klasike për meshkuj;
- të përzgjedhë tekstilin në përshtatje me modelin;
- të palosë tekstilin në varësi të modelit;
- të pozicionojë saktë mbi tekstil pjesët e kartmodelit duke ekonomizuar tekstilin;
- të kryejë shënimin e pjesëve të kartmodelit në tekstil, duke respektuar tolerancat për qepje, ciklatjet;
- të presë saktë sipas shënimit të tekstilit dhe materialet e tjera ndihmëse (astar, frazelinë);
- të kryejë punimin e dorës pekopjues për nxjerrjen e shënimeve nga ana tjetër e tekstilit;
- të bashkojë pjesët e palltos me ild;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të palltos;
- të kryejë evidentimin e defekteve në trup gjatë provës;
- të kryejë rregullimin e defekteve trupore të evidentuara në trup gjatë provës;
- të qepë pjesët e tekstilit;
- të qepë xhepat;
- të qepë pjesët e astarit;
- të qepë mostrat;
- të bashkojë astarin me tekstilin;
- të qepë jakën në trupin e palltos;
- të qepë mëngët;
- të qepë pencat;
- të kryejë proceset përfundimtare (birkopsat, kthimi i palës, hekurosja, pastrimi i fijeve);
- të kryejë llogaritje të thjeshta financiare, për konfeksionimin e palltove për femra dhe meshkuj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi realizon veshje në manekinë.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë teknikën mulazh për realizimin e veshjeve direkt në manekin;
- të përshkruajë mjetet e punës në teknikën mulazh;
- të ndërtojë veshje bazë në manekinë;
- të modifikojë dhe përshtasë modelin në manekin;
- të ndërtojë kartmodelin e pjesëve të veshjes nga teknika 3D në 2D;
- të zhvillojë kartmodelet nga pëlhura në letër dhe më pas në programin digjital.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi ndërton kartmodelin e veshjeve me metoda digjitale.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë programe të ndryshme digjitale për realizimin e kartmodelit të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e fundit të thjeshtë me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e pantallonit të thjeshtë me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e bluzës të thjeshtë me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e elementëve të veshjes (jaka, mëngë, xhepa, fileto, mostra etj) me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e xhaketës klasike për femra dhe meshkuj me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të ndërtojë kartmodelin e palltos klasike për femra dhe meshkuj me anë të programeve digjitale për ndërtimin e pjesëve të veshjes;
- të kryejë ekonomizimin e tekstit në formë digjitale;
- të kryejë provën e veshjes në formë digjitale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi krijon dhe prezanton koleksionin e modës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës;
- të vizatojë kartmodelin e veshjeve të skicuara;
- të presë pjesët e veshjes;

- të qepë pjesët e veshjes;
- të realizojë provën e veshjes;
- të kryejë proceset përfundimtare të veshjes;
- të planifikojë prezantimin e koleksionit;
- të realizojë prezantimin e koleksionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të konfeksionuar fustane, xhaketa, pallto për femra dhe meshkuj, për të realizuar veshje në manekinë, si dhe për të realizuar kartmodelin e veshjeve me metoda digjitale.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të konfeksionuar fustane, xhaketa, pallto për femra dhe meshkuj, për të realizuar veshje në manekinë, si dhe për të realizuar kartmodelin e veshjeve me metoda digjitale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Laboratori praktik për dizënjim mode.
 - Makina qepëse të drejta industriale, makinë overlock, kompjuter, programe digjitale për modelim, skaner, manekin, veglat e dorës. tavolinë përprerje, tavolina për modelim, tavolinë hekuri dhe hekur me avull për hekurosje, pëlhura të ndryshme, letra për kartmodele, astare, elastikë, zinxhira, kopsa etj.
 - Manuale, udhëzues, demonstrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

7. Moduli “Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HULUMTIMI DHE FRYMËZIMI PËR DIZAJNIN	M-10-2248-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të analizuar tregun, periudhat historike, zhvillimet stilistike, për të krijuar ide dizajni, për të përshkruar trashëgiminë kulturore shqiptare, për të krijuar një koncept të strukturuar për koleksionin e modës, bazuar në hulumtim, frymëzim dhe analizë të tregut, për të zhvilluar dhe projektuar koleksionin e modës, sipas teknikave bashkëkohore të prezantimit, si dhe për të prezantuar koleksionin ose produkte mode, duke përdorur mjete vizuale, teknike dhe digjitale.	
Kohëzgjatja e modulit	108 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individi analizon tregun për të zhvilluar ide dizajni. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të analizojë llojet e burimeve të informacionit për krijimin e dizajnit; – të analizojë informacione dhe të dhëna nga burime të ndryshme për të kuptuar nevojat dhe preferencat e tregu; – të shpjegojë rëndësinë e rolit të demografisë dhe segmentimit të tregut në dizajnin e modës; – të shpjegojë rëndësinë e njohjes së psikologjisë, nevojave dhe kërkesave të klientëve; – të krahasojë faktorët ekonomikë për të vlerësuar ndikimin e tyre në konsumin dhe përzgjedhjen e materialeve; – të përzgjedhë informacion të përshtatshëm për vendimmarrje krijuese; – të shpjegojë rëndësinë e arteve dhe zejeve shqiptare; – të shpjegojë rëndësinë e etnografisë dhe folklorit shqiptar; – të përdorë mjete digjitale dhe teknika kategorizimi për të strukturuar të dhënat e hulumtimit; – të shpjegojë mënyrat e kategorizimit të informacionit mbi hulumtimin dhe frymëzimin; – të shpjegojë rëndësinë e filtrimit të informacioneve në vendimmarrje;	

- të organizojë informacionin e mbledhur, sipas burimeve dhe temave që do të përdoret në procesin e dizenjimit.
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 2 Individi analizon periudhat historike dhe zhvillimet stilistike për të krijuar ide dizajni.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë ndikimin e periudhave të ndryshme stilistike në modë;
- të përshkruajë karakteristikat e artit prehistorik, mesjetë, rilindje, impero, romantizëm, kontemporan dhe futuristik;
- të përshkruajë karakteristikat e veshjeve në të gjitha periudhat historike deri në ditët e sotme;
- të përshkruajë siluetat, proporcionet, linjat, teksturat dhe ngjyrat e përdorura në periudha të ndryshme historike;
- të analizojë ndikimin e periudhave të modës në krijimin e koleksioneve bashkëkohore;
- të përshkruajë rëndësinë e ndikimit të shtëpive të modës dhe dizajnerëve në zhvillimin e stilit;
- të zbërthejë trendet aktuale dhe të ardhshme të modës për të zhvilluar ide krijuese që i përgjigjen tregut;
- të zbatojë njohuritë mbi trendet dhe ciklet e modës për të parashikuar dhe zhvilluar ide kreative;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 3 Individi përshkruan trashëgiminë kulturore shqiptare dhe elementët estetikë tradicionalë.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë rëndësinë e veshjeve, simboleve dhe ornamenteve tradicionale shqiptare në dizajn;
- të shpjegojë rëndësinë e arteve dhe zejeve shqiptare si burim frymëzimi në modë;
- të shpjegojë rëndësinë e etnografisë dhe folklorit shqiptar në zhvillimin e dizajnit estetik;
- të zhvillojë ide dizajni moderne, duke u bazuar në elemente të trashëgimisë kulturore shqiptare;
- të analizojë elementet tradicionale shqiptare për t'i përdorur në dizajne bashkëkohore me vlerë identitare;
- të përzgjedhë elemente nga historia, arti dhe kultura shqiptare për të krijuar dizajne frymëzuese;

- të shpjegojë rëndësinë e ndikimit të globalizmit në modë dhe ruajtjen e autencitetit në dizajn;
- të analizojë “Xhubletën Shqiptare” si trashëgimi kulturore e mbrojtur nga UNESCO;
- të vlerësojë mundësitë e përdorimit të saj në dizajn modern.
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 4 Individi krijon një koncept të strukturuar për koleksionin e modës, bazuar në hulumtim, frymëzim dhe analizë të tregut.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë fazat e zhvillimit të një koncepti dizajni për koleksion;
- të përdorë rezultatet e hulumtimit dhe frymëzimit për të ndërtuar narrativën e koleksionit;
- të përzgjedhë temën, stilin, elementët karakterizues si: ngjyrat, teksturat, siluetat dhe simbolet;
- të mbështetet në ndikimet historike, artistike, kulturore dhe sociale për të ndërtuar idenë bazë të koleksionit;
- të hartojë një përmbledhje konceptuale të projektit (*concept board, moodboard*);
- të vlerësojë përshtatshmërinë e konceptit me target-grupin dhe kërkesat e tregut;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi projektton një koleksion mode bashkëkohor.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të formulojë zgjidhje kreative që reflektojnë balancën mes estetikës, trashëgimisë dhe kërkesës së tregut;
- të përdorë informacione dhe të dhëna për të përcaktuar nevojat dhe preferencat e tregut në funksion të koleksionit;
- të analizojë dhe interpretojë nevojat dhe preferencat e një target-grupi specifik;
- të përzgjedhë tekstile dhe materiale në përputhje me konceptin, stilin dhe funksionalitetin e koleksionit;
- të vlerësojë faktorë ekonomikë që ndikojnë në dizajn,

- përfshirë buxhetin, kostot dhe tregun;
- të përdorë të dhënat e hulumtimit për të justifikuar zgjedhjet dizajnuese;
- të aplikojë mjete digjitale dhe vizuale për organizimin dhe paraqitjen e elementëve të koleksionit;
- të përzgjedhë temat dhe elementet frymëzuese në përputhje me segmentin e synuar të tregut;
- të përdorë njohuritë e fituara nga hulumtimi dhe analiza për të ndërtuar narrativën e koleksionit;
- të aplikojë njohuritë mbi siluetat, ngjyrat, teksturat dhe proporcionet në përputhje me trendet bashkëkohore;
- të skicojë veshjet e koleksionit në mënyrë kreative dhe funksionale, duke respektuar kërkesat teknike dhe estetike;
- të përdorë teknikat e prerjes dhe modelimit të veshjeve;
- të përdorë teknikat e modelimit në manekinë;
- të realizojë printime, stampa, qëndisje ose elemente të tjerë dekorative të tekstileve që do të përdoren në zhvillimin e koleksionit;
- të përgatitë skedën teknike të prodhimit me të gjithë elementet e saj;
- të realizojë në mënyrë digjitale kartmodelet e përdorur për zhvillimin e kampionit/ prototipit përfundimtar;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe profesionale në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.
- *Mood-board* dhe skica vizuale që ilustrojnë frymëzimin dhe linjën stilistike.

RN 6 Individi zhvillon koleksionin e modës, sipas teknikave bashkëkohore të prezantimit.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë elemente të dizajnit si silueta, proporcione, linja, tekstura dhe ngjyra për krijimin e pjesëve të koleksionit;
- të zhvillojë skicë ide në përputhje me konceptin e përzgjedhur;
- të aplikojë njohuritë mbi ciklet dhe trendet e modës në dizajnin bashkëkohor;
- të përdorë teknologji digjitale për paraqitjen e ideve (skica digjitale, prezantime);
- të zhvillojë albumin e frymëzimit (*mood-board*), duke përdorur metoda të ndryshme ilustruese, artistike dhe digjitale;
- të përgatitë një mini-koleksion me minimum veshje në

- vazhdimësi vizuale dhe narrative;
- të komunikojë në mënyrë profesionale dhe me gjuhë teknike idenë e projektit;
- të prezantojë koleksionin në mënyrë të strukturuar përmes formës vizuale dhe verbale (pitch, panel review).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 7 Individi prezanton koleksionin ose produkt mode, duke përdorur mjete vizuale, teknike dhe digjitale.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë elementet e hulumtimit, frymëzimit dhe trendit në një paraqitje vizuale të strukturuar (*mood-board*, paletë ngjyrash, tekstile, etj.);
- të përgatitë skica prezantuese dhe silueta për secilin model të koleksionit;
- të përdorë mjete digjitale për krijimin e prezantimit (poster, katalog, prezantim PowerPoint/ Canva, portofol online etj.);
- të përzgjedhë formatin më të përshtatshëm për komunikimin e koleksionit (ekspozitë, *pitching*, sfilatë, portofol, katalog);
- të shpjegojë idenë frymëzuese, elementet kryesore të dizajnit, funksionin dhe tregun e synuar për koleksionin;
- të realizojë një prezantim të shkurtër efektiv për koleksionin, të përshtatur për klientin/ investitorin/ jurinë;
- të demonstrojë qartësi, vetëbesim dhe kreativitet në komunikimin verbal dhe vizual të projektit të tij;
- të përdorë terminologji profesionale dhe stil prezantimi të përshtatshëm me sektorin e modës;
- të vlerësojë ndikimin e *influencer-ve*, mediave sociale, si dhe të burimeve vizuale në krijimin e koleksionit;
- të respektojë koherencën midis konceptit dhe formës së prezantimit final.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.
- Prezantimi final i koleksionit në format/ mënyrë të printuar, digjitale ose të ekspozuar.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ studio mode.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të analizuar tregun, periudhat historike, zhvillimet stilistike, për të krijuar ide dizajni, për të përshkruar trashëgiminë kulturore shqiptare, për të krijuar një koncept të strukturuar për koleksionin e modës, bazuar në hulumtim, frymëzim dhe analizë

	të tregut, për të zhvilluar dhe projektuar koleksionin e modës, sipas teknikave bashkëkohore të prezantimit, si dhe për të prezantuar koleksionin ose produkte mode, duke përdorur mjete vizuale, teknike dhe digjitale. – Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të analizuar tregun, periudhat historike, zhvillimet stilistike, për të krijuar ide dizajni, për të përshkruar trashëgiminë kulturore shqiptare, për të krijuar një koncept të strukturuar për koleksionin e modës, bazuar në hulumtim, frymëzim dhe analizë të tregut, për të zhvilluar dhe projektuar koleksionin e modës, sipas teknikave bashkëkohore të prezantimit, si dhe për të prezantuar koleksionin ose produkte mode, duke përdorur mjete vizuale, teknike dhe digjitale. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore. – Projektor, kompjutera, lap top, ekran interaktiv. – Manuale mode, revista, katalogë, arkiva online, platforma vizuale. – Blloqe skicimi, kartona, ngjyra, printime, gërshërë, ngjitës.

8. Moduli “Planifikimi dhe organizimi i punës në dizenjim mode”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS NË DIZENJIM MODE	M-10-2249-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përshkruar mënyrat e organizimit dhe strukturës së një studioje të dizajnit të modës, për të zbatuar planin për një produkt ose koleksion mode, për të planifikuar fushatë marketingu, për të ndarë dhe mbikëqyrur detyrat mes anëtarëve të ekipit, për të organizuar mbarëvajtjen e punës, si dhe për të raportuar ecurinë e punës në formatet përkatëse teknike dhe profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Individi përshkruan mënyrat e organizimit dhe strukturës së një studioje të dizajnit të modës. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë mënyrat e organizimit të një studio të dizajnit të modës; – të analizojë strukturën organizativetë saj, sipas roleve funksionale; – të analizojë në mënyrë të qartë dhe të plotë një porosi për veshje apo koleksion, në përputhje me kërkesat, specifikat dhe prioritetet e klientit; – të planifikojë koleksionin/veshjen/produktin në përputhje me tendencat aktuale të modës dhe karakteristikat e projektit; – të përcaktojë radhën e proceseve të punës dhe kohën për secilën fazë, duke e lidhur me produktivitetin dhe rrjedhshmërinë e punës; – të dokumentojë analizën e porosisë dhe planifikimin e koleksionit në formatet përkatëse, sipas standardeve profesionale; – të përdorë mjete të thjeshta digjitale për organizimin dhe vizualizimin e hapave të punës; – të argumentojë rëndësinë e interpretimit korrekt të porosisë për suksesin e projektit final;

- të shpjegojë ndikimin e modës në mjedis dhe etikën në industrinë e modës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 2 Individi zbaton planin për një produkt ose koleksion mode, në përputhje me strukturën teknike dhe afatet e kërkuara.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë burimet njerëzore të nevojshme, sipas kërkesave të projektit dhe profileve teknike të punës;
- të menaxhojë ndarjen e detyrave, sipas kualifikimit dhe proceseve të punës në ekip;
- të përdorë një plan pune dhe skedë teknike për të strukturuar fazat, afatet dhe përgjegjësitë në procesin e dizenjimit;
- të menaxhojë kohën dhe radhën e punës për të siguruar rrjedhshmëri dhe efikasitet në prodhimin e koleksionit;
- të reflektojë mbi performancën e ekipit;
- të sugjerojë përmirësime në planifikim dhe organizim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.

RN 3 Individi planifikon fushatë marketingu për një biznes të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përkufizojë konceptin e marketingut;
- të shpjegojë parimet bazë të tij;
- të përshkruajë funksionet e sistemit të informacionit në marketing;
- të shpjegojë llojet e reklamave dhe të përcaktojë kanalet efektive të shpërndarjes;
- të analizojë eventet speciale të modës, si pjesë e strategjisë promovuese;
- të analizojë format e tregtimit në dyqanet me shumicë dhe pakicë;
- të analizojë funksionet bazë të tregtimit, planifikimit, blerjes dhe shitjes në industrinë e modës;
- të përcaktojë çmimin e një produkti mode, duke marrë parasysh elementët e zinxhirit të vlerës dhe konkurrence;
- të interpretojë raportet e shitjeve dhe të planifikojë stoqet në përputhje me kërkesat sezonale;
- të shpjegojë marrëdhëniet midis prodhuesit dhe shitësit me pakicë dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje;
- të përcaktojë ciklet dhe sezonet e blerjes në modë;
- të zhvillojë dhe zbatojë një plan marketingu për një

- produkt të modës në një situatë reale apo simuluar;
- të përdorë rrjetet sociale, platformat digjitale dhe tregjet online, si pjesë e strategjisë së marketingut në modë;
- të zbatojë parimet e marketingut etik dhe të qëndrueshëm (*green marketing*) në promovimin e produkteve të modës;
- të reflektojë ndikimin e sjelljes së konsumatorit të ri (konsumatori etik, digjital dhe i ndjeshëm ndaj mjedisit) në zhvillimin e fushatave marketing;
- të përshkruajë strukturën organizative dhe funksionet e një dyqani të madh të shitjes me pakicë.
- të analizojë fuqinë konsumatore dhe ndikimin e saj në zhvillimin dhe promovimin e markave;
- të shpjegojë konceptin e imazhit të markës dhe rëndësinë e identitetit të saj në ndërtimin e besueshmërisë tek klientët.
- të respektojë rregullat dhe të drejtat e ekskluzivitetit të një marke mode.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi planifikon, ndan dhe mbikëqyrë detyrat mes anëtarëve të ekipit.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë burimet njerëzore të nevojshme për projektin, sipas profileve, roleve dhe aftësive të kërkuara;
- të ndajë e detyrat mes anëtarëve të ekipit në mënyrë të drejtë dhe funksionale;
- të mbikëqyrë përmbushjen e detyrave dhe ecurinë e bashkëpunimit në ekip;
- të reflektojë mbi dinamikën e ekipit;
- të sugjerojë përmirësime për rritjen e performancës;
- të demonstrojë aftësi në koordinimin dhe bashkëpunimin me kolegët për arritjen e një produkti cilësor dhe brenda afateve;
- të zbatojë praktika të etikës profesionale dhe të barazisë në organizimin e punës në ekip.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi organizon mbarëvajtjen e punës në një studio të dizajnit të modës.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të mbikëqyrë organizimin ergonomik të hapësirës, sigurisë dhe vendosjen funksionale të mjeteve të punës;
- të sigurojë pastërtinë dhe sistemimin e vendit të punës,

- gjatë gjithë procesit të dizenjimit;
- të dokumentojë procesin e punës, duke përdorur formatet përkatëse;
- të raportojë ecurinë e punës te stafi përkatës ose eprori;
- të analizojë kërkesat e një porositë apo projekti mode dhe të përpilojë një plan pune;
- të menaxhojë kohën në funksion të afateve dhe objektivave të projektit;
- të vlerësojë rëndësinë e fleksibilitetit dhe zgjidhjes së problemeve në situata të papritura, gjatë procesit të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 6 Individi raporton ecurinë e punës në formatet përkatëse teknike dhe profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë hapat e menaxhimit të një projekti mode (përgatitje, planifikim, realizim, ndjekje);
- të hartojë një grafik pune për një projekt mode, duke përcaktuar detyrat dhe afatet kohore;
- të përdorë formatet e përshtatshme për dokumentimin teknik (skeda teknike, tabela burimesh, fletë pune, etj.);
- të kryejë llogaritje të sakta të materialeve, mjeteve dhe shërbimeve të nevojshme për projektin;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një produkti ose shërbimi mode;
- të përgatitë një ofertë të thjeshtë për produkte apo shërbime, sipas një formati profesional;
- të zbatojë teknikat bazë të marketingut dhe mënyrat e promovimit në modë (online/offline);
- të ndjekë teknika të bazuara në fakte për vendimmarrje dhe përmirësim të projekti.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar mënyrat e organizimit dhe strukturës së një studioje të dizajnit të modës, për të zbatuar planin për një produkt ose koleksion mode, për të planifikuar fushatë marketingu, për të ndarë dhe mbikëqyrur detyrat mes anëtarëve të ekipit, për të organizuar mbarëvajtjen e punës, si dhe për të raportuar ecurinë e punës në formatet përkatëse teknike dhe profesionale.
- Individet duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune,

fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar mënyrat e organizimit dhe strukturës së një studioje të dizajnit të modës, për të zbatuar planin për një produkt ose koleksion mode, për të planifikuar fushatë marketingu, për të ndarë dhe mbikëqyrur detyrat mes anëtarëve të ekipit, për të organizuar mbarëvajtjen e punës, si dhe për të raportuar ecurinë e punës në formatet përkatëse teknike dhe profesionale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore.
 - Komputera, projektor, internet, platforma digjitale për marketing dhe rrjete sociale.
 - Manualë, udhëzues profesionalë, katalogë mode, revista të fushës, broshura tregtare, ekspozita online dhe materiale audiovizive që përshkruajnë praktikat reale të industrisë së modës.
 - Materiale ilustruese dhe didaktike që ndihmojnë në shpjegimin e koncepteve të marketingut, markave dhe konsumatorëve.
 - Mjetet e nevojshme për testim produktesh dhe realizim simulimesh për marketing dhe promovim (postera, etiketa, makete, materiale për ekspozim, etj.).
-

9. Moduli “Ideimi dhe skicimi i aksesorëve”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	IDEIMI DHE SKICIMI I AKSESORËVE	M-10-2250-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përshkruar rëndësinë e aksesorëve në projektimin e koleksionit dhe për të realizuar skicë teknike të tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	45 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Individi përshkruan rëndësinë e aksesorëve në projektimin e koleksionit. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë rolin e aksesorëve në historinë e veshjes; – të shpjegojë rëndësinë e aksesorëve në aspektin dekorativ, funksional dhe personalizues; – të përshkruajë llojet, klasifikimin, veçoritë dhe përdorimin e aksesorëve; – të përshkruajë rolin që luajnë aksesorët në raportin dhe harmoninë e elementëve të veshjes në një koleksion; – të shpjegojë mënyra të ndryshme për realizimin e aksesorëve. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
	RN 2	Individi skicon çantën dhe kuletën. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës; – të përshkruajë zhvillimin historik të çantës dhe kuletës; – të shpjegojë përshtatjen e linjave të çantës me linjat e veshjes; – të përshkruajë materialet e ndryshme që përdoren për realizimin e çantave dhe kuletave; – të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike; – të skicojë çanta;

- të skicojë kuletat;
- të eksperimentojë me çanta dhe kuletat;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi skicon këpucë, sandale, çizme, papuçe.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë materialet e ndryshme që përdoren për realizimin e këpucëve, sandaleve, çizmeve, papuçeve;
- të shpjegojë përshtatjen e llojeve të këpucëve, sandaleve, çizmeve, papuçeve, me koleksionet dhe linjat e veshjeve;
- të përzgjedhë materiale, teknika, dhe modele nga tradita shqiptare artizanale të veshjes së këmbës;
- të vizatojë këpucë, sandale, çizme, ose papuçe me teknika dhe materiale të ndryshme;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi skicon kravata dhe shalle të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë zhvillimin historik të gravatave, shalleve dhe fularëve;
- të përshkruajë rolin e gravatave, shalleve dhe fularëve në veshje;
- të përzgjedhë materialet dhe teknikat e ndryshme për realizimin e gravatave, shalleve dhe fularëve;
- të skicojë gravata, shalle dhe fularë;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi skicon kapelen.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë zhvillimin historik të kapeles;

- të shpjegojë përdorimin, llojet dhe funksionet e kapeleve (berreta, kapuçë, kësula etj);
- të përshkruajë përshtatjen e llojeve të kapeleve me linjat e veshjeve;
- të përshkruajë përdorimin e materialeve të ndryshme për realizimin e kapeleve me teknika dhe materiale të ndryshme;
- të skicojë një veshje të thjeshtë koke;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 6 Individi skicon doreza dhe rripa mesi.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë zhvillimin historik të doreza dhe rripa mesi;
- të përshkruajë llojet, përdorimet dhe përshtatjen e dorezave dhe rripave të mesit me linjat e veshjeve;
- të përshkruajë materialet dhe teknikat e ndryshme për realizimin e dorezave dhe rripave të mesit;
- të skicojë doreza dhe rripa të mesit me teknika dhe materiale të ndryshme;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 7 Individi skicon syze, freskore (erashka), çadra dhe bastunë.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë zhvillimin historik të syzeve dhe freskoreve (erashka), çadra dhe bastunë;
- të analizojë përshtatjen e syzeve dhe freskoreve (erashka), çadra dhe bastunëve në koleksione të ndryshme dhe linja të veçanta të veshjes;
- të përshkruajë përdorimin e materialeve dhe teknikave të ndryshme për realizimin e syzeve dhe freskoreve (erashka), çadrave dhe bastunëve;
- të dizenojë dhe modeljë syze dhe freskore (erashka), çadrave dhe bastunëve;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 8 Individi skicon bizhu.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës;
- të përshkruajë zhvillimin historik të bizhuve;
- të përshkruajë traditat shqiptare të argjendarisë;
- të përshkruajë llojet, funksionet dhe përshtatjen e bizhuve me linjat e veshjeve;
- të shpjegojë materialet dhe teknikat e ndryshme për realizimin e bizhuve;
- të dizenojë dhe modelojë bizhu;
- të përdorë teknologjinë digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përshkruar rëndësinë e aksesorëve në projektimin e koleksionit, për të modeluar dhe eksperimentuar me çantë, kuletë, këpucë, sandale, çizme, papuçe, si dhe për të skicuar, modeluar dhe realizuar kravata dhe shalle të ndryshme, kapele, doreza dhe rripa mesi, syze, freskore (erashka), çadra dhe bastunë, bizhu.
- Individet duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përshkruar rëndësinë e aksesorëve në projektimin e koleksionit, për të modeluar dhe eksperimentuar me çantë, kuletë, këpucë, sandale, çizme, papuçe, si dhe për të skicuar, modeluar dhe realizuar kravata dhe shalle të ndryshme, kapele, doreza dhe rripa mesi, syze, freskore (erashka), çadra dhe bastunë, bizhu.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore.
 - Dërrasë e zezë.
-

-
- Kompjuter, printer.
 - Projektor mësimor.
 - Tabela dhe pankarta ilustruese.
 - Materiale pune si: lapsa, letra, bojta, etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

10. Moduli “Modelimi i aksesorëve”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MODELIMI I AKSESORËVE	M-10-2251-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të modeluar dhe eksperimentuar me çantë, kuletë, këpucë, sandale, çizme, papuçe, kravata, shalle, kapele doreza, rripa mesi, bizhu, me materiale të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Individi modelon dhe eksperimenton me çantën dhe kuletën me materiale të ndryshme. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të eksperimentojë dhe realizojë çantën dhe kuletën me teknika dhe materiale të ndryshme; – të realizojë maketin 3D të çantës dhe kuletës; – të realizojë produktin final të çantës dhe kuletës; – të vendosë aksesorët, zbukurimet me teknika të ndryshme; – të vendosë etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar; – të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve; – të kryejë llogari të thjeshta për produktin. Instrumentet e vlerësimit: – Vlerësim me listë kontrolli.
	RN 2	Individi modelon dhe eksperimenton këpucë, sandale, çizme, papuçe. Kriteret e vlerësimit: Individi duhet të jetë i aftë: – të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës; – të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit; – të realizojë me teknika dhe materiale të ndryshme një veshjes të thjeshtë këmbë; – të vendosë aksesorët, zbukurimet me teknika të ndryshme;

- të vendosë etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar;
- të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve;
- të kryejë llogari të thjeshta për produktin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Individi modelon dhe realizon kravata dhe shalle të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të eksperimentojë dhe realizojë kravatën, shallin dhe fularin me teknika dhe materiale të ndryshme;
- të realizojë produktin final të kravatave dhe shalleve;
- të vendosë aksesoret, zbukurimet me teknika të ndryshme;
- të vendosë etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar;
- të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve;
- të kryejë llogari të thjeshta për produktin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Individi modelon dhe realizon kapelen.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit;
- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të realizojë një veshje të thjeshtë koke;
- të modelojë një veshje të thjeshtë koke;
- të vendosë aksesoret, zbukurimet me teknika të ndryshme;
- të vendosë etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar;
- të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve;
- të kryejë llogari të thjeshta për produktin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 5 Individi modelon dhe realizon doreza dhe rripa mesi.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit
- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të realizojë doreza dhe rripa mesi;
- të presë doreza dhe rripa mesi;
- të qepë doreza dhe rripa mesi;
- të vendosë aksesoret, zbukurimet me teknika të ndryshme;
- të vendosë, etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar;
- të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve;
- të kryejë llogari të thjeshta për produktin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 6 Individi modelon dhe realizon bizhu.

Kriteret e vlerësimit:

Individi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve të përdorimit
- të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- të realizojë bizhu me teknika dhe materiale të ndryshme;
- të krijojë bizhu me qëndisje dhe materiale zbukuruese;
- të krijojë bizhu me materiale ricikluese;
- të vendosë etiketat specifike dhe ambalazhin në produktin përfundimtar;
- të ekonomizojë përdorimin e materialeve, kohës dhe mbetjeve;
- të kryejë llogari të thjeshta për produktin;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit
dhe për vlerësimin
e individëve**

- Ky modul duhet të realizohet në laborator praktik për dizenjues mode dhe biznes.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të modeluar dhe eksperimentuar me çantë, kuletë, këpucë, sandale, çizme, papuçe, kravata, shalle, kapele doreza, rripa mesi, bizhu, me materiale të ndryshme.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të modeluar dhe

	eksperimentuar me çantë, kuletë, këpucë, sandale, çizme, papuçe, kravata, shalle, kapele doreza, rripa mesi, bizhu, me materiale të ndryshme. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë, laborator, tavolina, karrike, materiale të ndryshme tekstili, lëkure, astare, frazelina të ndryshme, makina qepse dhe prerëse, hekur, gershërë, gjilpëra të ndryshme, pinca, fije të ndryshme peri, fije metalike, shirita, aksesore funksionale dhe zbukurues, tantella, kopsa, perçina, fjongo, gure, temina, etj

11. Moduli “Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave grafike digjitale”

Kualifikimi profesional: “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT				
Titulli dhe kodi	REALIZIMI NËPËRMJET DIGJITALE	FIGURINËS TEKNIKAVE	NË MODË GRAFIKE	M-10-2252-25
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson individët për të përdorur mjetet dhe programet digjitale të figurinës, si dhe mjetet dhe teknikat digjitale për realizimin e figurinës.			
Kohëzgjatja e modulit	35 orë mësimore			
Niveli i parapëlqyer për pranim	Të kenë përfunduar të paktën një kualifikim të nivelit IV në KSHK, (arsimi i përgjithshëm, i mesëm artistik).			
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Individi përdor mjetet dhe programet digjitale të figurinës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Individi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë rëndësinë e programeve grafike digjitale, si dhe përdorimin e tyre në mode; – të shpjegojë rëndësinë e programeve digjitale si një vazhdimësi dhe perfeksionim të dizajnit me idetë artistike inovative; – të përdorë aftësitë digjitale në funksion të veprimtarisë; – të përdorë programin photoshop, ilustrator, clip, studio paint etj. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> – Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim. – Vlerësim me listë kontrolli. RN 2 Individi përdor mjetet dhe teknikat digjitale për realizimin e figurinës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Individi duhet të jetë i aftë: – të analizojë dhe eksperimentojë llojet e kontrasteve të ngjyrave me programe digjitale; – të krijojë figurinën nëpërmjet teknikave digjitale; – të krijojë tekstura të veshjes në figurinën digjitale; – të krijojë me teknika digjitale, detaje për modelin e krijuar në formë virtuale; – të përdorë ngjyrën me teknikat digjitale për modelin e			

krijuar në forme virtuale;

- të krijojë koleksionin vizual në mënyrë digjitale për paraqitjen e tij virtuale;
- të realizojë skicën teknike të modeleve të ndryshme të veshjeve me programe të ndryshme grafike digjitale;
- të realizojë koleksionin vizual në mënyrë të strukturuar për paraqitjen e tij.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e individëve

- Ky modul duhet të realizohet në klasë/ laborator praktik për dizenjues mode ose në laboratorin e informatikës.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë demonstrime konkrete për të përdorur mjetet dhe programet digjitale të figurinës, si dhe mjetet dhe teknikat digjitale për realizimin e figurinës.
- Individët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të individëve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve të shprehive praktike për të përdorur mjetet dhe programet digjitale të figurinës, si dhe mjetet dhe teknikat digjitale për realizimin e figurinës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore.
 - Kompjutera.
 - Laborator informatike.
 - Programe grafike digjitale.
-

IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të zbatuar në biznes

Kodi: P-10-016-25

Kohëzgjatja e praktikës profesionale vitin e I-rë është:

30 javë x 3 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 90 orë mësimore

Praktika profesionale e individëve në biznes do të kryhet bazuar në programin e përgjithshëm, si më poshtë:

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë praktike	Kompetencat profesionale	Koha (ditë/orë) 90 ditë/ 900 orë
1	Laboratori i skicimit artistik të produktit të modës	Realizimi i procesit të skicimit artistik të produktit të modës	- të skicojë figurinën në mënyrë manuale ose digjitale; - të skicojë figurinën në pozicione të ndryshme; - të skicojë elementët e veshjes me anë të teknikave të ndryshme; - të skicojë aksesore; - të përdorë ngjyrat në përshatshmëri me produktin e modës; - të përdorë psikologjinë e ngjyrave, gjatë ideimit të produktit të modës.	Çdo ditë
2	Laboratori i ndërtimit të kartmodelit	Ndërtimi i kartmodelit të produktit të modës në mënyrë manuale ose digjitale	- të marrë masat në trupin e njeriut; - të përdorë tabelën e përmasave; - të ndërtojë kartmodelin e pjesëve të produktit të modës në mënyrë manuale; - të ndërtojë kartmodelin e pjesëve të produktit të modës në mënyrë digjitale; - të respektojë shënimet dhe ciklatjet në skicën teknike të kartmodelit; - të kryejë ekonomizimin e tekstit në mënyrë digjitale; - të kryejë provën virtuale të produktit të modës.	Çdo ditë
3	Laboratori i prerjes	Prerja e pjesëve të kartmodelit	- të pozicionojë tekstin në anën e mbarë; - të palosë tekstil në varësi të modelit;	Çdo ditë

			- të pozicionojë pjesët e kartmodelit mbi tekstil, duke ekonomizuar tekstilin; - të përcaktojë tolerancat për qepjen; - të presë tekstilin, duke respektuar shënimet.	
4	Laboratori i qepjes	Qepja e produktit të modës	- të kryejë punimet e dorës; - të kryejë qepjen me syzator të anëve të tekstilit; - të bashkojë pjesët e kartmodelit; - të kryejë provën e qëndrimit në trup të produktit të modës; - të kryejë rregullimin e defekteve; - të kryejë proceset përfundimtare; - të kryejë kontrollin e cilësisë së produktit.	Çdo ditë
			Totali i kohës	90 ditë/ 900 orë

Kohëzgjatja e praktikës profesionale vitin e II-të është:

30 javë x 3 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 900 orë mësimore

Praktika profesionale e individëve në biznes do të kryhet bazuar në programin e përgjithshëm, si më poshtë:

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë praktike	Kompetencat profesionale	Koha (ditë/orë) 90 ditë/ 900 orë
1	Laboratori i ndërtimit të kartmodelit	Ndërtimi i kartmodelit të produktit të modës në mënyrë manuale ose digjitale	- të marrë masat në trupin e njeriut; - të përdorë tabelën e përmasave; - të ndërtojë kartmodelin e pjesëve të produktit të modës në mënyrë manuale; - të ndërtojë kartmodelin e pjesëve të produktit të modës në mënyrë digjitale; - të respektojë shënimet dhe cikatjet në skicën teknike të kartmodelit; - të kryejë ekonomizimin e tekstilit në mënyrë digjitale; - të kryejë provën virtuale të produktit të modës.	Çdo ditë

2	Laboratori i prerjes	Prerja e pjesëve të kartmodelit	- të pozicionojë tekstilin në anën e mbarë; - të palosë tekstil në varësi të modelit; - të pozicionojë pjesët e kartmodelit mbi tekstil duke ekonomizuar tekstilin; - të përcaktojë tolerancat për qepjen; - të presë tekstilin duke respektuar shënimet.	Çdo ditë
3	Laboratori i qepjes	Qepja e produktit të modës	- të kryejë punimet e dorës; - të kryejë qepjen me syzator të anëve të tekstilit; - të bashkojë pjesët e kartmodelit; - të kryejë provën e qëndrimit në trup të produktit të modës; - të kryejë rregullimin e defekteve; - të kryejë proceset përfundimtare; - të kryejë kontrollin e cilësisë së produktit.	Çdo ditë
4	Departamenti i zhvillimit	Organizimi i punës	- të analizojë porosinë në mënyrë të qartë dhe të plotë, për realizimin e produkteve të modës; - të hartojë planin e koleksionit, veshjes ose produktit në përputhje me tendencat aktuale të modës; - të menaxhojë burimet njerëzore në funksion të kërkesave të projektit dhe objektivave të punës; - të menaxhojë kohën dhe radhën e punës, për të siguruar rrjedhshmëri dhe produktivitet; - të ndajë detyrat mes anëtarëve të ekipit në bazë të aftësive dhe kompetencave përkatëse; - të mbikëqyrë organizimin ergonomik dhe funksional të hapësirës së punës; - të mbikëqyrë pastërtinë dhe rregullin e vazhdueshëm të vendit të punës gjatë gjithë procesit; - të bashkëpunojë në mënyrë	Çdo ditë

			efektive me kolegë dhe specialistë të tjerë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta; - të dokumentojë dhe raportojë me saktësi procesin e punës në formatet përkatëse.	
6	Departamenti i zhvillimit të produktit	Menaxhimi i detyrave administrative dhe tregtare.	- të menaxhojë dokumentet ligjore, teknike dhe financiare në një atelie ose studio mode; - të menaxhojë punën ditore, javore dhe mujore, duke përcaktuar hapat dhe kohëzgjatjen e secilit aktivitet; - të menaxhojë të dhëna financiare, fatura, oferta, inventarizim të mjeteve dhe materialeve për projekte mode etj.; - të kryejë llogaritje të nevojshme për materialet, mjetet, shërbimet, si dhe çmimin përfundimtar të një produkti apo shërbimi; - të mbledhë informacion nga furnizues dhe tregu për çmime, cilësi dhe disponueshmëri të materialeve dhe pajisjeve; - të menaxhojë fushata promovimi për produkte apo shërbime mode; të zgjedhë forma për trajnime dhe aktivitete profesionale për zhvillim të vazhduar profesional.	
			Totali i kohës	90 ditë/ 900 orë

Vendi i punës	Kompetencat personale	Veprimtaritë
Në të gjitha mjediset e dizenjimit të produktit.	• Korrektësia • Përpikmëria • Komunikimi • Pozitiviteti • Ndershmëria • Puna në grup • Zgjidhja e problemeve • Ruajtja e konfidencialitetit • Besueshmëria	Në të gjitha veprimtaritë

	• Menaxhimi dhe zgjidhja e konflikteve • Fleksibiliteti • Pavarësia • Gatishmëria për punë	
--	---	--

X. Program orientues për provimin përfundimtar në kualifikimin profesional “Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë” niveli V i KSHK.

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional **“Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK** përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në modulet mësimore që i përkasin këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individit.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucionit, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmblendhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime, me teste teorike dhe praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional **“Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë”, niveli V i KSHK** është hartuar duke u mbështetur në rezultatet e të nxënit, të cilat mbulojnë çështje teorike profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të këtyre RN-ve që mbulojnë dhe përmbajnë çështje teorike profesionale.

Njohuritë profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1: Modulet dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr.	Modulet	Peshat në %
1	Modelimi industrial dhe konfeksionimi	58%
2	Teknologji tekstili	14%

3	Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin	28%
	TOTALI	100%

Rezultatet e të nxënit për njohuritë profesionale të përfshira në programin orientues, janë:

1. Rezultatet e të nxënit nga moduli **“Modelimi industrial dhe konfeksionimi”**

- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e fundeve;
- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e pantallonit për femra dhe meshkuj;
- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e bluzës dhe këmishë për femra dhe meshkuj;
- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e fustanit;
- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e xhaketës;
- të listojë masat trupore të nevojshme për ndërtimin e palltos;
- të përshkruajë hapat për ndërtimin e kartmodelit të fundeve;
- të përshkruajë hapat për ndërtimin e kartmodelit të pantallonave;
- të përshkruajë hapat për ndërtimin e kartmodelit të bluzave;
- të përshkruajë hapat për ndërtimin e kartmodelit të fustaneve;
- të shpjegojë palosjen e tekstilit në varësi të modelit të veshjes;
- të shpjegojë mënyrën e pozicionimit të elementëve të kartmodelit mbi tekstil;
- të evidentojë tolerancat për qepje të pjesëve të ndryshme të veshjeve;
- të shpjegojë funksionin e punimeve të dorës pekopjues, ildi, qepja e fshehtë;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e fundit të thjeshtë;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e fundit verëf;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen pantallonave për femra dhe meshkuj;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e bluzave për femra dhe meshkuj;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e këmishave për femra dhe meshkuj;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e fustanit;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e jakave;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e mëngëve;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e pencave të ndryshme;
- të shpjegojë rradhën e punës për qepjen e qemerit;

2. Rezultatet e të nxënit nga moduli **“Teknologji tekstili”**:

- të klasifikojë fibrat tekstile;
- të shpjegojë karakteristikat e fibrave bimore;
- të shpjegojë karakteristikat e fibrave shtazore;
- të shpjegojë karakteristikat e fibrave të krijuara nga njeriu;
- të shpjegojë karakteristikat e lëkurave natyrore dhe ekologjike;
- të identifikojë seicilën nga fibrat tekstile në mënyrë organoleptike;
- të klasifikojë sistemet e filaturimit të fibrave;
- të përshkruajë sistemet e filaturimit të fibrave;
- të shpjegojë treguesit kryesorë të fijeve;
- të llogarisë hollësinë e fijeve;
- të shpjegojë numrat e fijeve;
- të përshkruajë mënyra të ndryshme të prodhimit të tekstileve;

- të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve të tezgjahuara;
- të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve të trikotuara;
- të shpjegojë procesin teknologjik të krijimit të tekstileve pa thurje;
- të shpjegojë krakteristikat e tekstileve të trikotuara dhe tezgjahuara;
- të përshkruajë trajtimet e ndryshme që i kryhen tekstileve.

3. Rezultatet e të nxënit nga modul ”Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin”:

- të shpjegojë rëndësinë e njohjes së psikologjisë, nevojave dhe kërkesave të klientëve;
- të shpjegojë llojet e burimeve të informacionit për krijimin e dizajnit;
- të shpjegojë rëndësinë e rolit të demografisë dhe segmentimit të tregut;
- të analizojë ndikimin e periudhave të ndryshme stilistike;
- të përshkruajë zhvillimin e tekstileve dhe të teknologjisë;
- të përshkruajë trendet e modës dhe ciklet e tyre;
- të përshkruajë siluetat, stilet, proporcionet dhe linjat në dizajn mode;
- të përshkruajë rëndësinë e ndikimit të burimeve të ndryshme të informacionit, shtëpive të modës si dhe dizajnerëve të ndryshëm;
- të shpjegojë ndikimin e influencësve dhe mediave sociale në dizajn mode;
- të shpjegojë fazat e krijimit të një koncepti dizajni;
- të shpjegojë rëndësinë e veshjeve, simboleve dhe ornamenteve tradicionale shqiptare;
- të shpjegojë rëndësinë e arteve dhe zejeve shqiptare;
- të shpjegojë rëndësinë e etnografisë dhe folklorit shqiptar;
- të shpjegojë rëndësinë e ndikimit të globalizmit në modë;
- të përshkruajë llojet e fibrave, fijeve dhe pëlhurave;
- të përshkruajë rëndësinë e ndikimit të teksturës dhe ngjyrës në dizajn mode;
- të shpjegojë mënyrat e kategorizimit të informacionit mbi hulumtimin dhe frymëzimin;
- të shpjegojë rëndësinë e filtrimit të informacioneve në vendimmarrje.

Udhëzime për vlerësimin:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me shkrim. Rekomandohet që provimi të kryhet me anë të një testi të parapërgatitur nga vetë shkolla. Testi duhet të mbulojë rreth 80% të rezultateve të të nxënit të listuara më sipër. Gjithashtu, rekomandohet që 50% e njësive të testit të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (deri në 4 alternativa) dhe pjesa tjetër të jenë njësi testi në formën e pyetjeve me përgjigje të hapur (individui duhet të japë edhe argumentet për përgjigjen e dhënë nga ana e tij/saj), pyetje me përgjigje të kufizuar etj. Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Niveli I:	Rikujtimi / Të kuptuarit
Niveli II:	Zbatimi / Analiza
Niveli III:	Sinteza/ Vlerësimi

Shkolla përcakton numrin maksimal të pikëve të testit dhe harton skemën përkatëse të vlerësimit. Në tabelën në vijim, rekomandohet që numri maksimal i pikëve të jetë 60 dhe shpërndarja e pikëve të bëhet në raport me peshën e çdo lënde dhe nivelet e vështirësisë.

Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr	Modulet	Peshat e module ve në %	Pikët për çdo modul	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Modelimi industrial dhe konfeksionimi	58	35	14	14	7
2	Hulumtimi dhe frymëzimi për dizajnin	28	17	7	7	3
3	Teknologji tekstili	14	8	3	3	2
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Kështu, njësitet e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë, por mund të marrin edhe 2 (dy) pikë nëse përmbajnë jo thjesht rikujtim por edhe analizë dhe llogaritje; njësitet me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda për brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga individit); njësitet me përgjigje të kufizuar dhe llojet e tjera të njësive të përfshira në test, marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrohen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundërt pikëve të fituara rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 15	4
16 - 23	5
24 - 30	6
31 - 39	7
39 - 48	8
49 - 54	9
55 - 60	10

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Dizenjim mode - Arsim i dyfishtë**”, **Niveli V në KSHK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet mësimore, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen individët, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr.	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Realizimi i skicës artistike të produktit të modës	Detyra 1: Realizimi i bluzës të modeluar	25
2	Realizimi i produktit të modës	Detyra 2: Realizimi i fundit të modeluar	25
3	Realizimi i produktit të modës	Detyra 3: Realizimi i pantallonit të modeluar	25
4	Realizimi i produktit të modës	Detyra 4: Realizimi i aksesoreve	25
		Shuma	100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të individëve në “detyra pune”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në mjediset e shkollës.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional” në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe individët, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Individit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatitë instrumentet përkatëse të vlerësimit, sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kriteret për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për realizimin e detyrave.

- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatitë udhëzuesin e përmbushjes për individët, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Realizimi i Detyrës 1: “Realizimi i bluzës së modeluar”.

- Individit duhet të testohet për një ose më shumë procese pune për realizimin e proceseve të punës së skicimit të bluzës së modeluar, ndërtimit të kartmodelit, prerjes dhe qepjes së saj.
- Individit i vihet në dispozicion pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Individit testohet për përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës, realizimin e skicës artistike të bluzës, përgatitjen e kartmodelit të saj, prerjen dhe qepjen e pjesëve të bluzës.
- Komisioni vlerësues mbikëqyrë individin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional, gjatë të cilit ai duhet të analizojë përzgjedhjen e aktiviteteve.
- Individit duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Realizimi i Detyrës 2: “Realizimi i fundit të modeluar”.

- Individit duhet të testohet për një ose më shumë procese pune për realizimin e proceseve të punës së skicimit të fundit të modeluar, ndërtimit të kartmodelit, prerjes dhe qepjes së tij.
- Individit i vihet në dispozicion pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Individit testohet për përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës, realizimin e skicës artistike të fundit, përgatitjen e kartmodelit të tij, prerjen dhe qepjen e pjesëve të fundit.
- Komisioni vlerësues mbikëqyrë individin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional, gjatë të cilit ai duhet të analizojë përzgjedhjen e aktiviteteve.
- Individit duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Realizimi i Detyrës 3: “Realizimi i pantallonit të modeluar”.

- Individit duhet të testohet për një ose më shumë procese pune për realizimin e proceseve të punës së skicimit të pantallonit të modeluar, ndërtimit të kartmodelit, prerjes dhe qepjes së tij.
- Individit i vihen në dispozicion pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Individit testohet për përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës, realizimin e skicës artistike të pantallonit, përgatitjen e kartmodelit të tij, prerjen dhe qepjen e pjesëve të pantallonit.
- Komisioni vlerësues mbikëqyrë individin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional, gjatë të cilit ai duhet të analizojë përzgjedhjen e aktiviteteve.
- Individit duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Realizimi i Detyrës 4: “Realizimi i aksesorëve”.

- Individi duhet të testohet për një ose më shumë procese pune për realizimin e proceseve të punës së skicimit të aksesorit dhe realizimit të tij.
- Individi i vihet në dispozicion pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Individi testohet për përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës, realizimin e skicës artistike të fundit dhe realizimin e tij.
- Komisioni vlerësues mbikëqyrë individin në procesin/proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional, gjatë të cilit ai duhet të analizojë përzgjedhjen e aktiviteteve.
- Individi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.